



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNËS - SHTIME
Komiteti për Politikë dhe Financa
Nr.01-060/01-8008/20 datë: 29.05.2020



Npi – 01/119 datë: 03.06.2020

Duke u bazuar në nenin 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 3.11 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/149 datë: 31.05.2019, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më: 03.06.2020 nxjerr këtë:

E K S T R A K T
P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË -IV- TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA
E mbajtur më datën: 03.06.2020 (e mërkurë) në ora 10.00 h. në sallën e Kuvendit Nr.1

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesja znj.Medina Brahaj, pastaj anëtarët e Komitetit z.Perparim Ramusa, znj.Arbresha Syla, z.Naim Zejna, znj.Zarife Rexhaj, z.Ruzhdi Jashari, dhe znj.Adelina Beqaj. Përveç anëtarëve të KPF-së në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: Zyrtarja Kryesore Financiare, znj.Kimete Ukaj; Zyrtari për barazi gjinore z.Reshat Gashi; Zyrtari i IT-së z.Gazmend Ademaj. Mbledhjen e hapi, Kryesuesja e KPF-së znj.Medina Brahaj, e cila pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë mbledhje është propozuar ky:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi i ekstrakt procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 24.02.2020,
2. Raporti vjetor Financiar për vitin 2019,
3. Raporti tremujor buxhetor Janar-Mars 2020,
4. Draft-Korrniza Afatmesme Buxhetore 2021-2023,
5. Rishqyrtimi i vendimeve të Kuvendit sipas raportit të vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ë,
6. Propozim-Vendim për formimin e Komisionit për zgjedhjen e drejtoreve të shkollave.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Hapi diskutimin për rendin e ditës,
z.Ruzhdi Jashari; Përshëndetje, meqenëse mund të thuhet se kaloi koha e rrezikut nga pandemia KOVID19, sipas obligimeve që keni marrë në Kuvendin paraprak ku keni thënë se do ta përgatitni një raport të detajuar për sa i përket ndarjes së mjeteve financiare prej 100.000€ për pandeminë, sot unë kërkoj që kjo të futet si pikë shtesë, e rendit të ditës, meqenëse nuk e keni propozuar si pikë të rregullt.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Sqaroi se së shpejti në muajin Korrik do ta kemi mbledhjen e radhës, dhe do ta kemi edhe reportin.

z.Perparim Ramusa; Përshëndetje, pajtohem me rendin e ditës, ndërsa lidhur me propozimin e Ruzhdiut unë mendoj se është heret por do ta kemi një raport të tillë.

z.Naim Zejna; Përshëndetje, mendoj se do ta kemi reportin, por sa i përket rendit të ditës unë po kërkoj që rendi i ditës të mos ngarkohet. Po ashtu sa i përket kësaj ne kemi kërkuar edhe më herët por

edhe tani po kërkojmë edhe një zyrtarë ndihmës për Sekretarinë e Kuvendit, sepse e kemi vërejtë se vetëm një zyrtar është i ngarkuar aty dhe për këtë arsy e edhe Procesverbalet nuk po i marrim me kohë.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj: Konstatoi kuorumin prej 5 anëtarëve prezent në mbledhje.

* Komiteti për Politikë dhe Financa, me 4 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim” aprovoi rendin e ditës.

Pika 1

Shqyrtimi i ekstrakt procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 24.02.2020

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Hapi diskutimin për këtë pikë. Meqenëse diskutime nuk kishte Kryesuesja Konstatoi kuorumin prej 5 anëtarëve prezent në mbledhje.

* Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht, aprovoi ekstrakt procesverbalin nga mbledhja e mbajtur, më 24.02.2020.

Pika 2

Raporti vjetor Financiar për vitin 2019

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Fjalën për prezantimin e kësaj pike ja dha Kimete Ukaj.

znj.Kimete Ukaj, zyrtare kryesore financiare; Pasi përvendosni të gjithë të pranishmit, e prezantoi Raportin Vjetor Financiar për 2019. Raporti është vonuar për shkak të Pandemisë KOVID19. Raporti është përgatitur sipas standardeve ligjore, mbi bazën e shpenzimit të buxhetit dhe sipas Kategorive ekonomike. Raportin ne e kemi përgatitur në formë të shkruar dhe ua kemi dërguar me kohë, (shih dokumentin). Në vazhdim lexoi raportin sipas tabelave financiare. Në fund unë jam gati të përgjigjem në pyetjet e juaja, dhe ju ftoj që ti rekomandoni Kuvendit për aprovim.

z.Naim Zejna; Nuk do të jem i gjatë. E falënderoj zyrtaren për raportin e detajuar, por kam një shqetësim te faqja 22 te tejkalimi, si dhe te faqja 25 te detyrimet kontigjente, ku kemi një detyrim jashtëzakonisht të madh. Dhe një pyetje, qka është kjo kompenzim i dëmit te Zona Ekonomike?

z.Ruzhdi Jashari; Te tabela Nr.3 është mirë me e pas një spjegim, është i detyrueshëm. Po ashtu një spjegim nevoitet edhe te shpenzimet kontigjente?

znj.Kimete Ukaj, zyrtare kryesore financiare; Te tabela Nr.3 aty është një sqarim ku spjegoitet, vetem duhet të lexohet. Po ashtu 2,607,000 është diferenca aty ku është tabela Nr.5. Në vazhdim i sqaroi me shifra konkrete sipas tabelave, duke i lexuar shifrat. (shih dokumentin). Te projektet kapitale faqe 15 është klauzula që thot, se është shpenzuar vetëm 1,450,000€ (afërsisht). Te faturat e pa paguara, janë dy fatura, njëra është te shtëpia e komunitetit, dhe tjetra është për firmën “Ardhmëria”. Kemi pas tejkalim ku mjetet janë marrë nga viti i kaluar. Te detyrimet kontigjente ne nuk mundemi me e ditë se a i humbim apo i fitojmë proceset Gjyqësore, medoj se më detajisht mundet me ditë Zyrtari Ligjor këtë qështje.

z.Ruzhdi Jashari; Te shpenzimet kontigjente, nuk mundet me u planifikuar, por a ka mundësi që ne me e ditë në kumulativ. Ose psh. ne me ditë se sa ka pas detyrime të përgjithshme në Arsim, Administratë ose sektore tjera, sepse shuma prej 200,000€ është një shumë e mjeteve financiare bukur e madhe. Kjo duhet me na brengosë të gjithëve, pavarësisht që i keni numrat për miratim.

znj.Kimete Ukaj, zyrtare kryesore financiare; Ne emrat i kemi, por unë po them që këtu, nuk i kemi vetëm procedurat e vitit 2019 por janë edhe nga 2018, 17 etj.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj: Konstatoi kuorumin prej 7 anëtarëve prezent në mbledhje.

* Komiteti për Politikë dhe Financa, me 4 vota “Për” me 1 votë “Kundër” dhe me 2 vota “Abstenim” vendosi t’i rekomandoj Kuvendit aprovimin e Raportit vjetor Financiar për vitin 2019.

Pika 3

Raporti tremujor buxhetor Janar-Mars 2020

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Fjalën për prezantimin e kësaj pike ja dha Kimete Ukaj.
znj.Kimete Ukaj, zyrtare kryesore financiare; Raportin ne e kemi përgatitur në formë të shkruar dhe ua kemi dërguar me kohë, (shih dokumentin). Në vazhdim lexoi reportin sipas tabelave financiare, në vija të trasha. Jam këtu që të përgjigjem në pyetjet e juaja eventuale, dhe ju ftoj që ti rekomandoni Kuvendit për aprovim.

z.Naim Zejna; Nuk do ta zgjas shumë. Shqetësues është realizimi i buxhetit ku nuk ka pasur ndikim pandemia. Realizimi i buxhetit është shumë i vogël nëse e krahasojmë me periudhën e njejtë të vitit të kaluar, përvet kategorisë Pagat dhe Mëditjet të tjerat janë të mangëta.

z.Ruzhdi Jashari; Unë kam një pyetje, 4,950€ pak më poshtë tabelës i kemi shifrat më të vogla, si e spjegoni këtë? Pastaj 2 milion i kemi nga Ministria për gypat e kanalizimit, ndërkaq që gypat janë në një vend ku paguhet qira, a mos keni marrveshje me pronarin që të kryhet kjo qira a qka është puna, a mundesh me na e sqaruar? Unë kërkoj që të jenë më efikas Inspektorët në këto gjëra.

znj.Kimete Ukaj, zyrtare kryesore financiare; Siq e dini deri më 14 Mars nuk është aprovuar Buxheti i Kosovës, dhe ne kemi punuar në shpenzimin e buxhetit sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës me 1/12 pjesë të Buxhetit Komunal, plus e ka ndarë në 50%. Qka kemi bërë ne, ose qka kemi pas mundësi të bëjmë ne, vetëm kemi bërë mbulimin e projekteve dy vjeqare, që kanë qenë obligim i yni. Asnjë projekt i ri nuk ka mundur të investohet. Projektet rregullisht alokohen një muaj mbrapa, kështu që në krahasim me alokimin janë realizuar 47% të shpenzimeve buxhetore. Donacionet në Arsim janë të bartura nga muaji Janar në muajin Mars.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj: Konstatoi kuorumin prej 7 anëtarëve prezent në mbledhje.

* Komiteti për Politikë dhe Financa, me 3 vota “Për” me 1 votë “Kundër” dhe me 2 vota “Abstenim” vendosi t’i rekomandoj Kuvendit aprovimin e Raportit tremujor buxhetor Janar-Mars 2020.

Pika 4

Draft-Korrniza Afatmesme Buxhetore 2021-2023

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Fjalën për prezantimin e kësaj pike ja dha Kimete Ukaj.
znj.Kimete Ukaj, zyrtare kryesore financiare; Drafti i KAB-it, është dokument strategjik, mbi bazën e të cilit pastaj do të bëhet edhe planifikimi buxhetor deri në vitin 2023. KAB-i miratohet për çdo vit nga Kuvendi i Komunës. Përmes këtijë drafti faktikisht caktohen objektivat e Komunës, i cili ka edhe bazën Ligjore. Bazuar në Ligjin dhe rregulloren Komunale Draft-Korrniza Afatmesme Buxhetore 2021-2023, duhet të shkojë fillimisht në debat publik e pastaj të aprovohet në Kuvend. Besoj se do të kemi kohë të mjaftueshme për ta diskutuar bashkërisht. Dokumentin e keni marrë me kohë, sidoqoftë unë po ua lexoi disa na pikat më kryesore, (shih dokumentin). I mirpres pyetjet e juaja, dhe ju ftoj që ti rekomandoni Kuvendit për ta nxjerrë në diskutim publik.

z.Perparim Ramusa; E falënderoj ZKF-në për sqarimet që na i dha. Propozoj që KAB-i të shkojë në diskutim publik me sygjerimin që të marrim pjesë në diskutim dhe ta japim kontributin tonë.

z.Naim Zejna; I bashkëngjitem parafolësit, por kërkoj që KPF-ja të përfshihet aktivisht në procesin e diskutimit publik. Unë mendoj se gjatë diskutimit publik kemi me pas sfida.

znj.Kimete Ukaj, zyrtare kryesore financiare; Te tabelat 6, 7 kjo shumë e buxhetit është për krejt kategoritë buxhetore, por sa munden të futen dhe të realizohen do ta shohim.

z.Ruzhdi Jashari; Unë propozoj që përmes teje direkt duhet të jenë pjesëmarrës edhe Kryetarët e fshatrave dhe bashkësive të Shtimes, në diskutim publik. Nuk mund të kemi sukses, pa e përfshi edhe komunitetin lokal, por prej zyrës së Kryetarit.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Sa i përket debatit publik për buxhet, unë personalisht jam kujdesur që të thrras qoftë përmes SMS, ose drejtpërdrejt thirrjeve telefonike por nuk janë përgjigjur,

nuk ka pas interesim përveq një numri të vogël. Po e qojmë KAB-in në debat publik dhe do ti shohim mundësitet për ta shqyrtuar sa më mirë.

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj: Konstatoi kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

* **Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t'i rekmandojoj Kuvendit aprovimin e vendimit për ta nxjerrë në diskutim publik për 15 ditë, Draft – Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale 2021-2023.**

Pika 5

Rishqyrtimi i vendimeve të Kuvendit sipas raportit të vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ë

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Lexoi kérkesat, dhe tha se në asnjérin rast nuk kemi shkelje ligjore, por këto dy vendime janë kthyer për arsy se nuk kemi Hartat Zonale. Ne jemi në procedurë të miratimit të këtyre Hartave Zonale, dhe dmth. kjo është arsyja kryesore që i kthyer MAPL-ja këto dy vendime në rishqyrtim. Në vazhdim hapi diskutimin për këtë pikë.

* **Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi që këto dy vendime të shqyrtohen në pako.**

z.Naim Zejna; Ne tani a po marrim vendim për anulim apo po i lëmë në pritje deri të miratohen Hartat Zonale.

z.Perparim Ramusa; Këto janë dokumente strategjike që kërkojnë kohë deri sa të miratohen, kështu që ne edhe po deshëm nuk mund të vendosim ndryshe sepse MAPL-ja ka thënë se ka shkelje Ligjore. Unë jam i mendimit që mos me i anuluar, por për me i pezulluar deri në miratimin e Hartave Zonale.

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Rekomandimi i Zyrtarit Ligjor është që të anulohen deri në miratimin e Hartave Zonale.

z.Ruzhdi Jashari; Çdo shtyrje prodhon vetem probleme, prandaj unë jam për me hjekë këtë sherr, sepse ata nuk janë të paditur. Unë mendoj se duhet të veprojmë sipas Ligjit, të anulohen vendimet ashtu si ka kérkuar Ministria si dhe Zyrtari Ligjor.

z.Perparim Ramusa; Unë jam për me u votuar sipas Rekomandimit të Zyrtarit Ligjor, që të anulohen vendimet.

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj: Konstatoi kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

* **Komiteti për Politikë dhe Financa, me 4 vota “Për” dhe me 2 vota “Abstenim” vendosi t'i rekmandojoj Kuvendit, që Vendimet e Kuvendit të Komunës së Shtimes Npi-01/389 dhe Npi-01/390 të Anulohen deri në miratimin e Hartave Zonale të Komunës së Shtimes.**

Pika 6

Propozim-Vendim për formimin e Komisionit për zgjedhjen e drejtoreve të shkollave

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Fjalën për prezantimin e kësaj pike ja dha Agime Roshaj.

znj. Agime Roshaj, drejtoresh e DKA; Pasi përvihendti të gjithë të pranishmit, prezantoj para Kuvendit, Propozim-Vendimin për formimin e Komisionit për zgjedhjen e drejtoreve dhe zavendës drejtoreve të shkollave. Propozim-Vendimin e keni marrë me kohë. Ne si ekzekutiv kemi emëruar Fatmir Zymerin zyrtar për arsim dhe Basri Hyseni Kryetar i Këshillit të Prindërve. Tani për ta kompletuar Komisionin mbetet edhe zgjedhja e dy anëtarëve nga Kuvendi.

z.Perparim Ramusa; Faleminderit drejtoresha e arsimit, me sa e kuptova drejtoreshën ne e kemi Udhëzimin Administrativ në bazë të cilit ne duhet të punojmë. Unë pajtohem me propozimin e juaj që nga drejtoria të jetë Fatmir Zymeri, nga këshilli i prindërve Basri Hyseni, si dhe Ministria e dërgon përfaqësuesin e vetë.

z.Naim Zejna; Ne po vijmë në një pozitë të aktit të kryer për me votuar kandidatë të propozuar nga ju. E qka nëse ne nuk i aprovojmë. Pastaj është edhe tjetra se është vëllim i madh i punëve nuk e di a mundet me i kryer.

z.Ruzhdi Jashari: Ne faktikisht veq po u dashka me i qu duart. Udhëzimi Administrativ është më i vogël se Ligji, kështu që duhet me e kqyrë mirë Ligjin e Arsimit se mos kanë kolizion. Nëse thot U.A. ashtu atëherë kryene punën ju vet pa ne.

z.Perparim Ramusa: Sa po kuptoj unë, ne edhe mundemi që të mos i votojmë, por propozimi im është që këta dy emra të votohen.

znj.Arbresha Syla; Përshëndetjem, në fakt Kuvendi paska mundësi me ndërhy, nëse e vlerësojmë se është propozim pa vend. Nëse e parasheh MASHT-i përfaqësimin e prindërve, dhe ai faktikisht është, neve krejt qka na mbetet është se mund të intervenojmë te përfaqësuesi i drejtorisë së arsimit. Por në këtë rast unë jam që ta përkrahim, sepse u janë përmbajtur plotësisht kriterieve të Udhëzimit Administrativ.


znj.Zarife Rexhaj; Përashëndetje, unë mendoj se kandidatët e propozuar duhet votuar, sepse i plotësojnë të gjitha kriteret me Udhëzim Administrativ, si dhe janë adekuat. Ndërsa sa i përket anëtarit të tretë, është Udhëzimi Administrativ që e ka përcaktuar ashtu. Unë do ti përkrahu dhe do ta votoj, këtë propozim-vendim, për zgjedhjen e komisionit.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj: Konstatoi kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

* **Komiteti për Politikë dhe Financa, me 4 vota “Për” 1 votë “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim” vendosi t’i rekomandoj Kuvendit aprovin e Propozim-Vendimin për formimin e Komisionit për zgjedhjen e drejtorëve të shkollave, sipas propozimit të Drejtorisë Komunale për Arsim.**

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj: Pasi që diskutime tjera nuk kishte, Kryesuesja mbledhjen e përfundoi ne ora 11.30h.

Procesmbajtësi:
Idajet Rexhepi



Kryesuesja e KPF
Medina Brahaj